

UDHËZIM I PËRBASHKËT

MBI

VEPRIMTARINË E SEKSIONIT TE POLICISË GJYQËSORE

Duke patur parasysh:

- Rëndësinë e madhe le funksionimit sa me te shpejte te strukturave te Policisë Gjyqësore te Seksionit te Prokurorisë;
- Problemet qe janë krijuar ne Administratën Doganore dhe Prokuroritë e rretheve për zbatimin e drejte te Ligjit Nr.8677 dale 02.11.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë gjyqësore";
- Me qellim për te unifikuar praktiken zbatimin e njëjte te funksionimit te strukturave te oficerëve te Administratës Doganore ne seksionet e prokurorisë,

UDHËZOJMË:

- 1 Oficeret e Policisë Gjyqësore te Administratës Doganore ne seksionin e Prokurorisë, kane për detyre kryesore te kryejnë veprime hetimore te plota e te gjithanshme kryesisht ose me urdhrin e delegimit te Prokurorit, për zbulimin e autoreve dhe për sigurimin e provave për veprimtarinë e tyre kriminale, si dhe detyra te tjera te parashikuara ne Kodin e Procedurës Penale, me qellim zbatimin e ligjit penal
Oficeret e Policisë Gjyqësore te seksioneve nuk mund te ngarkohen me detyra qe nuk kane lidhje me veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, qe janë caktuar ose deleguar nga Prokurori kompetent, përveç rasteve te urgjencës ose për nevoja te trajnimit, për te cilat është njoftuar dhe marre pëlqimi i Drejtuesit te prokurorisë pranë se cilës funksionon seksioni i Policisë Gjyqësore.
2. Veprimtaria e oficerëve te Policisë Gjyqësore drejtohet dhe kontrollohet nga Prokurori, sipas rregullave te përcaktuara ne Kodin e Procedurës Penale.
Oficeret e Policisë Gjyqësore te Administratës Doganore do te qëndrojnë dhe kryejnë veprime hetimore, ne zyrat Prokurorisë. Pranë Prokurorive te rretheve do te ketë zyra te veçanta ku do te punojnë oficeret e Policisë Gjyqësore. Dhe ne degët e Rajoneve doganore do te ketë zyra te veçanta ku oficeret e Policisë Gjyqësore mund te kryejnë veprime hetimore. Prokuroritë e Rretheve detyrohen te pajisen me mjetet e punës (dosje, kancelari etj) oficeret e Policisë Gjyqësore pranë këtyre seksioneve.

Autoritetet Doganore detyrohet te pajisen me radio dore dhe pajisje te tjera qe u takojnë punonjësve te Departamentit Operativ e Hetimor.

4. Oficeret e Policisë Gjyqësore te Administratës Doganore te seksionit te Prokurorisë çdo dite fillimi pune do te paraqiten tek Prokuroritë e Rrethit qe i kane ne vartësi për te informuar për detyrat kryera ne zbatim te urdhrave të delegimit si dhe për te marre detyrat e tjera.
5. Për ngjarjet kriminale si kontrabande dhe vepra të tjera kriminale te krimin ekonomik te ndodhura, veprimet e para hetimore, këqyrja e vendngjarjes si dhe veprime te tjera te ngutshme si rregull do te kryhen nga oficeret e Policisë Gjyqësore te Administratës Doganore qe ndodhen ne seksionet pranë Prokurorisë. Menjëherë oficeri i Policisë Gjyqësore informon Prokurorin për ngjarjen e ndodhur dhe veprimet e kryera, duke zbatuar dispozita e Kodit te Procedurës Penale. Ne ato raste kur ngjarjet e ndodhura janë larg qendrave te seksioneve te Policisë Gjyqësore , veprimet e para te ngutshme, si këqyrja e vendit te ngjarjes, fiksimi dhe sekuestrimi i provave materiale, arrestimi ne flagrante i autoreve te veprës penale, kontrollet e banesave te tjera qe parashikohen ne Kodin e Procedurës Penale, kryhen nga oficeret e Policisë Gjyqësore ne Departamentin Operativ e Hetimor.
Kur nga autoritetet doganore konstatohet kontrabandë njoftojnë menjëherë oficerin e policisë gjyqësore te doganës përkatëse.
- 6 Për ngjarjet kriminale qe ndodhin, Organet Doganore marrin masa dhe te vene ne dispozicion mjetet për te shkuar grupi hetimor ne vendin e ngjarjes sa me shpejtë. Prokuroritë e rretheve ne çdo dy muaj përpilojnë listën e Prokuroreve dhe oficerëve te Policisë Gjyqësore te seksioneve, qe do te jene te gatshëm për ndjekjen dhe hetimin e çdo ngjarjeje kriminale. Kjo liste afishohet ne çdo Prokurori organe te administratës Doganore.
7. Fashikujt e procedimeve penale qe do te ndiqen nga oficeret e Policisë Gjyqësore te seksioneve te shërbimeve te Administratës Doganore, do te jene te regjistruara ne regjistrin e procedimeve qe mban Prokurori. Këto fashikuj do te merren me firme nga ana e oficerëve te Policisë Gjyqësore nga Sekretaria e Prokurorisë.
8. Për njohjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi, ngarkohen strukturat e Prokurorisë, seksionet e Policisë Gjyqësore, shërbimet e Policisë Gjyqësore ne strukturat e Administratës Doganore.

Ky Udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE

KASTRIOT ISLAMI

PROKURORI I PERGJITHSHEM

ARBEN RAKIPI

